



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 73 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 14 / 05 / 2025

VENDIM

Nr. 15 date 14 / 05 / 2025

PËR

PUNIMET E RIKONSTRUKSIONIT TE DIGES SE MANSKURISE”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 14.05.2025 mori në shqyrtim situatën problematike në digën e Manskurise ku gjate një inspektimi në terren të përfaqësuesve të KKDM dhe të Ndermarrjes rajonale të Ujesjelles Kanalizimeve Durrës (UKD) u konstatuan kryerja e punimeve ndertimore në trupin e digës pa leje ndertimi, pa praninë e mbikqyrësit të punimeve të caktuar nga Investitori, pa krijimin e kushteve të sigurisë në punë për punonjësit, pa kontroll të materialeve të ndërtimit dhe në mungesë të dokumentacionit teknik të duhur për zbatimin e punimeve sipas kërkesave të ligjit.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

- 1- **Ti kërkoj Agjencise Kombetare të Ujesjellës - Kanalizimeve (AKUK) dhe UKD pezullimin e punimeve për rikonstruksionin e digës së Manskurise deri në miratimin e lejes së ndërtimit të këtij objekti, dhe paraqitjen e dokumentacionit të plote teknik të miratuar nga Investitori sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi duke përfshirë projekt zbatimit e plote të plotësuar sipas kërkesave të nenit 10 dhe Nenit 14 të VKM se mesiperme si dhe të Vendimit të KKDM Nr. 15, datë 28.06.2024, plan organizimin e punimeve si dhe marrjen e masave konkrete të sigurisë në punë në objektin e digës së Manskurise.**
- 2- **Ti kërkoj Agjencise Kombetare të Ujesjellës - Kanalizimeve (AKUK) dorëzimin e dokumentacionit të duhur për miratimin nga KKDM të mbikqyrësit të punimeve sipas kërkesave të nenit 20 të VKM se mesiperme. Njekohesisht, Investitori duhet të krijoj kushtet e duhura për kontrollin e punimeve nga ITD sipas kërkesave të nenit 21 të VKM se mesiperme**
- 3- **Rifillimi i punimeve mund të kryhet vetëm pas plotësimit të kërkesave të mesiperme dhe njoftimit të ITD për të qenë prezent gjatë zbatimit të punimeve për rikonstruksionin e kësaj dige**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM dhe ITD për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

